



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.212/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Blerim Dina – Kryetar panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, kundër njoftimit mbi anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Shërbime te veçanta kontraktues për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës se Prishtinës, me nr. të prokurimit: 616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK-Prishtinë, më datën: 06.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET, si e pa lejuar ankesa e operatorit Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime te veçanta kontraktues për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës se Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK-Prishtinë.

II. VERTETOHET, njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Shërbime te veçanta kontraktues për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës se Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK-Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, hedhet si e palejuar, i

bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 03.04.2020 me nr. 212/20, kundër njoftimit mbi anulim të aktivitetit me titull: “Shërbime te veçanta kontraktues për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës se Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 51 dhe 52 të Ligjit nr.04/L-042 të LPP-së i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin me numër nr.04/L-237, Ligji nr.05/L-68 dhe Ligji nr.05/L-092 , nenin 47 dhe 48 paragrafi 1.2., 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 95 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e Ligjit te Procedurës Kontestimore, dispozitat e nenit 9.1 dhe 9.2 te kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ ose profesionale dhe Udhëzimin Administrativ Nr.3/2015 dt.05.03.2015, neni 30.1 te kriteret e dhënies sipas dosjes së tenderit për kontratën publike kornizë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë:02.04.2020, ka autorizuar ekspertin profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e datës: 29.04.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë i OE ankues është se sipas nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, autoriteti kontraktues ka parapatë si kriter që OE duhet të këtë staf profesional, të paktën 3 jurist me provim të jurispodencës, ku është cekur që të dëshmohet që juristët të kenë diplomë- certifikatën e jurispodencës (e nuk është kërkuar licenca).

Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në nenin 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit më ka eliminuar si OE që nuk kam dorëzuar licencën e dy avokatëve (kriter që nuk është kërkuar në dosje të tenderit) edhe pse unë në dosjen e tenderit për stafin tim profesional kam dëshmuar me 3 (tre) jurist me diplomë dhe certifikatë të jurisprudence ashtu siç është kërkuar.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë dhe ne kërkesat e AK sqaron kërkesë e AK-së ne DT tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qenë:

Përshtatshmëria profesionale:		Dëshmia e kërkuar dokumentare:	
1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.		1. Kopje te regjistrimit te biznesit se bashku me veprimtaritë e regjistrimit.	
2. 1. ne baze te Ligjit për Avokatinë, neni 2 Zyra e Avokatit Avokatët mund ta ushtrojnë avokatinë në zyrën individuale, në zyrën e përbashkët të avokatëve ose në shoqërinë të avokatëve, të regjistruar në regjistrin e Odës. OE duhet te ofroj dëshmi se është i regjistruar ne regjistrin e Odes.		2. Certifikatën përkatëse	

9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare	
	1. Stafi Profesional Te paktën 3 jurist me provim te jurisprudence	1. Diploma e certifikata e jurisprudence	

Gjithashtu eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit te ofertës se OE ankues konstaton se ne ofertën në fjalë tek stafi profesional ka te bashkangjitur certifikatat e dy juristëve të cilat dëshmojnë se personat në fjalë kanë përfunduar provimin e jurisprudence po ashtu edhe z. Fatmir Gashi ka vërtetim të lëshuar nga Ministria e shërbimeve Publike Departamenti i Administratës gjyqësore ku thuhet se ka dhënë provimin e Judikatures me dt.25.06.2006.

Eksperti shqyrtues ka kërkuar ndihme profesionale ne Oden e Avokateve te Kosovës por nuk ka marre përgjigjeje ne lidhje me këtë çështje Pyetja përmes e-mailit citoj:

Hafseje Zenullahu

Fri 2/7/2020 8:14 AM

To:

Oda e Avokatëve të Kosovës <info@oak-ks.org>;

A iu lejohet Juristeve te diplomuar me certificate te jurspodences por te cilët nuk kane licencë nga Oda e Avokatëve të Kosovës te përfaqësojnë Autoritetin kontraktues ne seanca gjyqësore për “Shërbime te veçanta “ pasi qe nuk janë te regjistruar ne Oden e Avokateve te Kosovës por janë ne kuadër te stafit te një Operatori ekonomik, A.M e cila është e regjistruar ne Oden e Avokateve dhe ka licencën nga Oda e Avokateve apo duhet patjetër qe vet A.M te marre pjese ne seanca gjyqësore te Komunës?

Pyetja e dytë drejtuar Odës se Avokatëve;

Duke iu uruar një dite te palodhshme kërkoj, nga ana e juaj qe te me jepeni përgjigjeje ne lidhje me pyetjen time, për shkak se Seanca pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit është mbajtur dje, ku isha fizikisht ne zyrat e juaja por nuk pata mundësi te marre përgjigjeje për shkak te kohës se shkurtër kështu qe pa marre përgjigjeje nga ana e juaj Vendimi i OSHP-se mbetet pezull, për shkak te paqartësive ne lidhje me këtë pyetje .

Ndërkaq me datën 10.02.2020 Oda e Avokateve te Kosovës me kthen përgjigjeje citoj:

Ju lutem, ne jemi ne trajtim te kërkesës suaj, ju lutem se çka keni nënkuptuar ku i jeni referuar AM.

Eksperti shqyrtues ia sqaron sinjalet ne lidhje me A.M por, Oda e avokatëve nuk ka kthyer përgjigjeje ne lidhjeje me këtë pyetje të pa qartë për Ekspertin shqyrtues por Oda e avokateve nuk ka dhënë përgjigjeje ne lidhje me këtë çështje.

Eksperti shqyrtues duke pasur para sysh kërkesat e parashtruara ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë thekson se sa i përket kërkesat në dosjen të tenderit si dhe kërkesave tekniko-profesionale ku edhe është konsideruar i papërgjegjshëm OE, Eksperti shqyrtues Operatori ekonomik konstaton se OE ankues i ka plotësuar të gjitha kërkesat ne dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë,

Eksperti shqyrtues në seancën dëgjimore kam cekur së ka plotësuar kërkesën e AK por së a iu lejohet juristët ta përfaqësojnë autoritetin kontraktues me qene se nuk janë avokat ka qenë e pa qartë për Ekspertin kështu që iu është drejtuar Odes se Avokatëve si me lartë.

Eksperti shqyrtues duke shfletuar ligje ne fuqi si Ligji mi avokatinë, Ligji për procedure kontestimore ku tek Ligji mbi avokatinë tek neni 1.1. Avokatia – profesion që merret me dhënien e ndihmës juridike;

Neni 24 Të drejtat dhe detyrimet e praktikantit

1, Praktikanti është i detyruar të kryejë të gjitha punët që ia beson avokati dhe detyrohet t'u përmbahet udhëzimeve të tij.

1.10. Përfaqësim – përfaqësim apo mbrojtje në procedurë;

Ndërsa tek neni:

Neni 20 Zëvendësimi i avokatit

1. Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti i punësuar në zyrën e tij ose ndonjë avokat tjetër në pajtim me këtë ligj.

2. Praktikantit të punësuar në zyrën e avokatit nuk i nevojitet autorizimi zëvendësuar për përfaqësim.

3. Praktikanti është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të avokatit që e zëvendëson.

4. Për shkeljet e bëra nga praktikanti, përgjegjësinë materiale e bartë avokati, te i cili është i punësuar praktikanti.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të këtyre fakteve ligjore dhe duke analizuar rastin konkret mendon se Ardita Morina mund t'i autorizojë juristët e diplomuar me provim të jurspodencës njësoj sikur të kishin qenë avokat bazuar në Neni 20.1 citoj: 1. Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti i punësuar në zyrën e tij ose ndonjë avokat tjetër në pajtim me këtë ligj.

Pasi që juristët kanë edhe provimin e jurispodences mundet me autorizim të përfaqësojnë rastet kur Ardita Morina vet nuk mund të përfaqësojë në seanca për Komunën e Prishtinës ku edhe përmbush kërkesën me 3 (tre) jurist me diplomë dhe certifikatë të jurispodencës ashtu siç është kërkuar. Në rast se Ardita Morina nuk mund ta përmbushë kërkesën e Autoritetit kontraktues, AK mund ta penalizojë.

Bazuar në të lartcekurat ky pretendim ankimor qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi tjetër i OE ankues është sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar Autoriteti Kontraktues me ka eliminuar me pretendimet që çmimi i ofertuar nga OE Ardita Morina tejkalon çmimin e tregut.

Eksperti shqyrtues konstaton se është në të drejtën e Autoritetit kontraktues në lidhje me çmimet e tregut që të hulumtoj tregun dhe ta respektoj Nenin 1 të LPP-se .

Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në nenin 30.1 të dosjes së tenderit më ka eliminuar me pretendimet se çmimi i ofertuar nga OE tejkalon çmimin e tregut në bazë të rregullores së tarifave të Odës së avokatëve, gjë që në dosjen e tenderit kriter për dhënien e tenderit kanë qenë që OE të jetë i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, e nuk ka qenë kriter që çmimet të jenë sipas rregullores së tarifave të Odës së Avokatëve.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në ligjin për Tarifatat e Avokateve Neni 4. 1. Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj tarife, Avokati dhe Klienti ose personi i autorizuar mundë të kontraktojnë shpërblimin për

shërbimet e Avokatit dhe shpenzimet shoqëruese me marrëveshje të lirë ndërmjet tyre. Gjithashtu nuk ka qenë kërkesë e AK që të respektohen tarifat e avokateve. Prandaj bazuar në nenin 51 dhe 52 të Ligjit për Prokurimin Publik mund të bëjë marrëveshje të lirë për çmim. Andaj nga sqarimet që u dhanë me lart del se kjo arsyeje e eliminimit nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Sa i përket pretendimit se Autoriteti kontraktues në afatin ligjor të përcaktuar nga paneli shqyrtues i Prokurimit pa e shqyrtuar fare lëndën e duke i shkelur dispozitat e nenit 51 dhe 52 të Ligjit për Prokurimin Publik i plotësuar dhe i ndryshuar,

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues ka nxjerrë vendimin mi anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u bazuar në propozimin e ekspertit dhe Vendimin e OSHP-së brenda kornizave ligjore dhe afateve kohore. Prandaj ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në nenin 30.1 të dosjes së tenderit dhe dispozitat e nenit 4 paragrafit 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, dhe 4.9 të Udhëzimit administrativ Nr.3/2015 dt.05.03.2015 më ka eliminuar duke bërë krahasime me çmimet me oferta të ndryshme me njëra tjetrën në bazë të rregullores së tarifave të Odës së avokatëve, gjë që në dosjen e tenderit kriter për dhënien e tenderit nuk ka qenë ky kriter, kriter kanë qenë që OE të jetë i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët sipas Udhëzimit Administrativ Nr.3/2015 dt.05.03.2015.

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk ka qenë kriter që të respektohen tarifat e Odës së avokatëve. Prandaj ky pretendim është i qëndrueshëm,

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka nxjerrë vendimin në kundërshtim me nenin 95 të Ligjit NR.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative sepse në seancën dëgjimore nuk e ka ftuar ankuesin (OE Ardita Morinen), dëshmitarët (Oden e Avokateve të Kosovës) dhe ti jap të drejtën ligjore ankuesit, për ta dëgjuar dhe për të paraqitur provat dhe faktet të cilat do të ishin përcaktuese për nxjerrje të vendimit meritor në pajtim me normat, rregullat në fuqi,

Eksperti shqyrtues konstaton se në Seancën dëgjimore ka qenë pjesëmarrës edhe Operatorët ekonomik ankues dhe eksperti shqyrtues ku Operatori ekonomik ka pasur mundësi që të ofrojë dëshmitë në seance si i tillë ky pretendim nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Pretendimi i radhës nga ana e OE ankues se Avokati i cili është i licencuar ne Oden e Avokatëve te Kosovës. sipas Ligjit te procedurës kontestimore, ka të drejtë që bashkëpunëtori i tij (juristi) me autorizim bartës te avokatit të marrë pjesë në seancë civile, administrative dhe ekonomike, Eksperti ka shkëputur neni 90 pika 90.4 Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti që është duke punuar tek ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë.

Neni 50 Shkeljet disiplinore

1. Avokatët dhe praktikantët përgjigjen për shkelje të lehta dhe të rënda të detyrës dhe prestigjit të avokatisë para organeve disiplinore të Odës, të përcaktuara me Statut.

Përgjigje në Pretendimi nr.7

Autoriteti Kontraktues me Vendimin e dt. 17.03.2020 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e veçanta kontraktuale” për përfaqësinë ligjore për nevojat e Komunës së Prishtinës“ 2019 me numër të prokurimit 616-19-8564-2-2-1, ka bërë shkelje të nenit 47 dhe 48 paragrafi 1.2., 1.3. 1.4, 1.5, 1.6 dhe 95 të Ligjit nr.05/l-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mbi obligimin ligjor që duhet të përmbajë një akt administrativ, sepse ankuesit nuk i ka siguruar palës mundësi që ta kuptoj aktin administrativ. Pra, Vendimi nuk përmban elementet dhe informacionet e nevojshme të Aktit Administrativ siç është përcaktuar me nenin 48 të këtij Ligji.

Ne lidhje me këtë, Eksperti shqyrtues konstaton se Vendimi nuk përmban disa elemente te cekura si i tille ligjërisht nuk është i plotë, prandaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues duke u bazuar ne disa ligje ne fuqi i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht si e bazuar, dhe rekomandon që të Anulohet vendimi i AK për Anulimin e Aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues dhe Operatori Ekonomik nuk janë deklaruar se a pajtohen apo nuk pajtohen me mendimin e ekspertes profesionale.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 06.05.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të

prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertës profesionale të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertës profesionale, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit është vendosur sipas vendimit 12/20 të datës 06 shkurt 2020. Sipas këtij vendimi paneli shqyrtues ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues ndërkaq ka lënë në fuqi vendimin e autoritetit kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit, për faktin se është vërtetuar se AK kur ka hartuar dosjen e tenderit dhe ka publikuar njoftimin për kontratë nuk ka paraparë qartë kërkesat e tij për shërbime konsulence. Më saktësisht AK tek neni 9. 1 dhe 9. 2 i dosjes së tenderit- kapaciteti teknik dhe profesional. Andaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lartë Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues profesional, në vendimin e datës 06 shkurt 2020, ka konstatuar se pretendimi ankimor i OE ankues për shkelje të nenit 9. 1 dhe 9. 2 të DT është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor për arsyen e eliminimit për shkak të çmimit ka dhënë mendim sipas vendimit 12/20 andaj konsiderohet si "Res Judicata".

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se Autoriteti kontraktues në afatin ligjor të përcaktuar nga paneli shqyrtues i OSHP-së pa e shqyrtuar fare lëndën e duke i shkelur dispozitat e nenit 51 dhe 52 të Ligjit për Prokurimin Publik i plotësuar dhe i ndryshuar, ka marrë vendim, paneli shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues ka nxjerrë vendimin mi anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u bazuar ne propozimin e ekspertit dhe Vendimin e OSHP-së brenda kornizave ligjore dhe afateve kohore, prandaj ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues (OSHP) gjithashtu ka nxjerrë vendimin në kundërshtim me nenin 95 të Ligjit NR.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative sepse në seancën dëgjimore nuk e ka ftuar ankuesin (OE Ardita Morinen), dëshmitarët (Oden e Avokateve te Kosovës) dhe ti jap të drejtën ligjore ankuesit, për ta dëgjuar dhe për të paraqitur provat dhe faktet të cilat

do të ishin përcaktuese për nxjerrje të vendimit meritor në pajtim me normat, rregullat ne fuqi, paneli shqyrtues konstaton se në Seancën dëgjimore ka qene pjesëmarrës Operatoret ekonomik ankues dhe eksperti shqyrtues ku Operatori ekonomik ka pasur mundësi qe ti ofrojë dëshmitë ne seancë, dhe për këtë egziston si dëshmi procesverbali i mbajtur në OSHP me datën 06 shkurt 2020, dhe si i tille ky pretendim nuk qëndron.

Paneli shqyrtues sqaron se sipas vendimit 12/ 20 te datës 06 shkurt 2020, ka konstatuar se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në harmoni me nenin 62 të LPP-së për faktin se oferta e operatorit ekonomik ankues nuk ka qenë konform kërkesave të AK-së dhe duke pasur parasysh faktin se nuk ka pasur oferta tjera të përgjegjshme, paneli shqyrtues ka konstatuar se vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit, duhet të mbetet në fuqi.

Paneli shqyrtues sqaron se duke pas parasysh faktin se aktiviteti i prokurimit është anuluar për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme, dhe duke u bazuar në faktin se kërkesat e hartuara nga AK në nenin 9. 1 dhe 9. 2 të dosjes së tenderit nuk kanë qenë të hartuara qartë, AK mund ta ri tenderoj aktivitetin e prokurimit nëse edhe më tej ka interes, dhe OE ankues dhe OE tjerë mund të aplikojnë në këtë aktivitet të prokurimit, andaj duke u bazuar në këtë fakt paneli shqyrtues konstaton se ankesa e OE ankues në këtë fazë, është e palejuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- "KK- Prishtinë",
- 1x1 OE- Avokat "Ardita Morina"- Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.